



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

KOMISIONI I QIRADHËNIES SË TOKAVE BUJQËSORE TË PANDARA

Nr. 8017 prot.

Korçë më, 31. 07.2026

VENDIM

Nr. 28, Datë 31. 07.2026

“Për dhënie me qira të sipërfaqes prej 64 900 m² me numër pasurie 438 ZK. 1491 dhe sipërfaqe prej 50 100 m² me numër pasurie 446/2 ZK. 1491 të ndodhura në fshatin

Dishnicë, Njësia Administrative Bulgarec”

Bazuar në ligjin Nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, në VKM Nr. 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, si dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, u zhvillua procedura e dhënies me qira të tokave bujqësore, si më poshtë:

- Sipërfaqja prej 64 900 m² me numër pasurie 438 ZK. 1491
- Sipërfaqja prej 50 100 m² me numër pasurie 446/2 ZK. 1491, të ndodhura në fshatin Dishnicë, Njësia Administrative Bulgarec, Bashkia Korçë.

Zëri kadastral i pasurive Nr. 438 dhe Nr. 446/2 ZK.1491 në fshatin Dishnicë, NJA Bulgarec, u konfirmua nga DAMT, Këshilli i Qarkut Korçë me anë të shkresës Nr. 546/1 prot. datë 12.05.2026, protokolluar pranë Bashkisë Korçë me Nr. 4447/1 prot. datë 13.05.2026.

Bashkia Korçë i ka në pronësi pasuritë e sipërpërmendura dhe është pajisur me certifikata pronësie. Me shkresën Nr. 3814 prot. datë 16.04.2026 i është kërkuar Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Korçë dhe Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrotjtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Korçë, për caktimin e përfaqësuesve në Komisionin e Qiradhënies së Tokave Bujqësore të Pandara.

Bazuar në nenin I.2 të Udhëzimit Nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, Këshilli i Bashkisë Korçë miraton sipërfaqet e tokave bujqësore që mund të jepen me qira, me anë të Vendimit Nr. 122, datë 01.12.2016.

Bazuar në nenin 54 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe në pikën I.3 të Udhëzimit Nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, me Urdhërin Nr. 736, datë 23.06.2026 Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e autoritetit qiradhënës krijon Komisionin e Qiradhënies së Tokës Bujqësore të Pandarë (KQTBP), me përbërje si më poshtë:

1. Sotiraq Filo – Kryetar i Bashkisë Korçë
2. Thanas Koroveshi – Përgjegjës i Sektorit të Bujqësisë në Bashkinë Korçë
3. Gjergjiana Pupa – Përgjegjëse e Sektorit të përditësimit, regjistrimit dhe inventarizimit të pronave të Bashkisë Korçë
4. Artur Lisi – Përfaqësues nga DAMT, Këshilli i Qarkut Korçë
5. Robert Muçollari – Përfaqësues i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Korçë

Më datë 10.07.2026 me anë të shpalljes Nr. 7300 prot. Kryetari i Bashkisë Korçë fton subjektet e interesuara të depozitojnë kërkesat brenda 10 ditëve nga data e shpalljes. Data e zhvillimit të konkursit është caktuar më 27.07.2026 ora 11:00, në Bashkinë Korçë.

Më datë 17.07.2026 është paraqitur kërkesa për marrje me qira tokë bujqësore nga subjekti Dion Titili, me numër personal H70206033W, i cili paraqiti dokumentat ligjore si më poshtë:

- Kërkesë për marrje me qira, Nr. 7300/1 prot. datë 17.07.2026,
- Plan i hollësishëm i biznesit, ku është përcaktuar punësimi në vitin (1-2) i 2 punonjësve me kohë të pjesshme, si dhe rritjen e numrit të punonjësve nga viti i 5 e në vazhdim duke angazhuar punonjës sezonalë, gjatë periudhave të punimeve intensive bujqësore si korrje dhe mirëmbajtje e kulturave bujqësore, dhe investimi në fazën e I 6,732,000 lekë,
- Burimi i financimit garantohej nga:
 - Fondet vetjake të individit,
 - Kapitali personal i investitorit,
 - Të ardhurat operative nga aktiviteti blegtoral,
 - Vlera e aktiveve ekzistues blegtorale (20 lopë + 250 desh + mjete bujqësore).
- Oferta për tarifën mujore është 6500 lekë/ha/vit për një periudhë prej 99 vjetësh, bazuar në kulturën e mbjelljes,
- Fotokopje e kartës së identitetit.

KQTBP u mbledh në datë 27.07.2026 ora 11:00, ku u paraqitën anëtarët si më poshtë:

1. Thanas Koroveshi – Përgjegjës i Sektorit të Bujqësisë në Bashkinë Korçë
2. Gjergjiana Pupa – Përgjegjëse e Sektorit të përditësimit, regjistrimit dhe inventarizimit të pronave të Bashkisë Korçë
3. Artur Lisi – Përfaqësues nga DAMT, Këshilli i Qarkut Korçë
4. Robert Muçollari – Përfaqësues i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor Korçë

Nuk u paraqit Kryetari i Bashkisë Korçë Z. Sotiraq Filo, pasi rezulton të jetë me lejë të zakonshme nga data 27.07.2026-30.07.2026 (leje bashkëngjitur), si dhe Urdhëri Nr. 877, datë 23.07.2026. Referuar Udhëzimit Nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, neni 5/a:

– Kryetari i Bashkisë, në cilësinë e autoritetit qiradhënës ka për detyrë shqyrtimin e kërkesave të paraqitura nga subjektet për marrjen me qira të tokës si dhe marrjen e vendimit nga komisioni. Për sa më lart, në unanimitet anëtarët prezent në mbledhje vendosën shtyrjen e datës për shqyrtimin e kërkesës së dorëzuar dhe marrjen e vendimit për në datë 31.07.2026 ora 11:00, me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të KQTBP.

Bashkëngjitur këtij vendimi, procesverbali Nr. 7873 prot. datë 27.07.2026 i (KQTBP).

KQTBP u mblodh në datë 31.07.2026 ora 11:00 në prani të gjithë anëtarëve dhe mori në shqyrtim kërkesë-ofertën e dorëzuar për këtë procedurë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të subjektit, KQTBP vlerësoi se ka mungesë dokumentacioni në kërkesën e dorëzuar nga Dion Titili. Për këtë arsye, Komisioni i Qiradhënies së Tokave Bujqësore të Pandara, i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr. 736, datë 23.06.2026:

VENDOSI

1. Të skualifikojë subjektin Dion Titili identifikuar me NID: H70206033W, pasi ka mungesë dokumentacioni.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Ministrisë së Bujqësisë, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi KQTBP.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

Komisioni i Qiradhënies së Tokave Bujqësore të Pandara

1. Sotiraq Filo
2. Thanas Koroveshi
3. Gjergjiana Pupa
4. Artur Lisi
5. Robert Muçollari

